

Tabela 4: Mjaftueshmëria e Kapitalit (çdo tremujor)

(I) Informacion cilësor

Informacion permbljedhes mbi metoden standarte per vleresimin e mjaftueshmerise se kapitalit te bankes:

Banka e Tiranës, bazuar në rregulloren për "Raportin e Mjaftueshmerise se Kapitalit" perlogarit mjaftueshmerine e kapitalit si raport ndermjet shumes se kapitalit rregullator me shumen e ekspozimeve te ponderuara me rrezikun. Asetet e ponderuara me rrezikun jane llogaritur si shume e :a) Aseteve te ponderuara me rrezikun per rrezikun e kredise dhe rrezikun e kredise se kunderpartise (zerat e bilancit te ponderuara me rrezik dhe zerat jashte bilancit te ponderuara me rrezikun mbas aplikimit te faktorit te konvertimit te kredise) b) Kerkeses per kapital per rrezikun e tregut shumezuar me 12.5 c) Kerkeses per kapital per rrezikun operacional shumezuar me 12.5. Niveli minimal i ketij raporti eshte 15%. Norma e mjaftueshmerise se kapitalit per tremujorin e trete te vitit 2015 eshte 21.67% kundrejt normes se mjaftueshmerise se kapitalit 21.25 % te perlogaritur ne tremujorin e dyte te vitit dhe normes 18.22% perlogaritur ne tremujorin e pare te vitit 2015.

(II) Informacion sasior

1 Zerat e ekspozimeve dhe eks. te mundshme te ponderuara me rrezikun e kredise sipas Metodes Standarte

Nr.	Zerat e ekspozimeve dhe te ekspozimeve te mundshme	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
		Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	1,699,267,477	1,694,034,800	1,488,597,460
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	7,360	12,729	7,802
3	joqeveritare/jofitimprurëse)	278,092,120	278,062,574	278,067,375
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	3,441,774,630	3,203,320,406	3,006,021,208
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	13,656,994,206	13,561,482,455	12,359,701,514
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	5,802,437,909	5,402,137,448	5,534,023,143
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	2,460,431,860	1,957,239,434	1,777,964,772
8	Ekspozime (kredi) me probleme	6,258,163,080	5,848,928,844	5,896,528,133
9	Zëra të tjerë	3,363,747,700	3,455,140,567	3,530,746,492
	Total	36,960,916,343	35,400,359,256	33,871,657,900

2 Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut ", sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", të shumëzuara me 12.5 :

Kerkesat per kapital per rrezikun e tregut	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke
a) Kerkesa per kapital per aktivitetin ne librin e tregtueshem*	0	0	0
a.1) Rreziku i pozicionit	0	0	0
a.2) Rreziku i perqendrimit	0	0	0
b) Kerkesa per kapital per te gjitha pozicionet e bankes	0	0	18,615,473
b.1) Rreziku i shlyerjes	0	0	0
b.2) Rreziku i pozicioneve ne mallra	0	0	0
b.3) Rreziku i kursit te kembimit	0	0	18,615,473
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut te shumezuar me 12.5	0	0	232,693,413

*Banka e Tiranës nuk ka pozicione ne instrumenta financiare e ne mallra te mbajtura me qellim tregtimin e tyre.

3 Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas metodës standarde, e përcaktuar në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", të shumëzuara me 12.5

	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional	463,707,086	439,474,264	439,474,264
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional e shumezuar me 12.5	5,796,338,571	5,493,428,297	5,493,428,297

4 Raporti i Mjaftueshmerise se Kapitalit

	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
	Vlerat ne %	Vlerat ne %	Vlerat ne %
Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë/aktive të ponderuara me rrezikun (në %).	18.22	21.25	21.67
Raporti i kapitalit të nivelit të parë/aktive të ponderuara me rrezikun (në %).	18.22	21.25	21.67
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (në %).	18.22	21.25	21.67

Tabela 6 : Rreziku i kredise: Informacion i pergjithshem (cdo tre mujor)

(I)

Informacion Cilesor

Informacion permbledhes mbi rrezikun e kredise:

1 Perkufizimi i Kredive me probleme:

Banka e Tiranës konsideron Kredi me Probleme kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme. Banka e Tiranës klasifikon kredite e saj ne klasat e mëposhtme ne perputhje me rregulloren e Bankes se Shqiperise “Per administrimin e rrezikut te kredise nga bankat dhe degjet e bankave te huaja”.

1. Kredi standarde
2. Kredi ne ndjekje
3. Kredi nenstandarde
4. Kredi te dyshimta
5. Kredi te humbura

Tre kategorite e fundit (konkretisht kredite nenstandarde, te dyshimta dhe te humbura) perbejne edhe kredite e klasifikuara me probleme. Kredite e klasifikuara ne dy klasat e para perbejne kredite e rregullta.

Provigjonimi i kredive behet ne perputhje me kriteret e rregullores “Per administrimin e rrezikut te kredise nga bankat dhe degjet e bankave te huaja” si ne drejtim te kriterëve per provigjonim, ashtu edhe ne drejtim te normave te provigjonimit.

Banka e Tiranës synon ruatjen e nje profili prudent te rrezikut, duke i dhene prioritet: a) ruajtjes se nje baze te forte kapitali, (b) ruajtjes se nje baze te diversifikuar te burimeve te financimit, (c) perforcimit te bilancit te saj, (d) ruajtjes se cilesise se asetëve dhe diversifikimin e portofolit te kredise dhe (e) manaxhimin efektiv te shpenzimeve operacionale.

Ne drejtim te rrezikut te kredise:

- ♦ Banka synon te kontrolloje rrezikun e kredise nepermjet kriterëve te shendosha te kredidhenies, te lidhura ne menyre te drejteperdrejte me aftesine e kredimarresit dhe cilesine e kolateralit;
- ♦ Banka synon reduktimin e kredive ne vonese nepermjet identifikimit ne kohe te rrezikut, monitorimit te vazhdueshem dhe sjelljes proaktive;
- ♦ Banka operon nen limitet e kredidhenies te percaktuara nga Grupi dhe synon monitorimin direkt dhe te centralizuar te ekspozimeve ne nivel klienti dhe grupi te klienteve te lidhur.

Tabela 7: Informacion per portofolin e kredise sipas metodes standarte (cdo tremujor)

(I) Informacion cilesor

1 Emrat e institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA), si dhe arsyet e çdo ndryshimi;

Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch, të njohura nga Banka e Shqipërisë si agjensi të pranuarat të vlerësimit të kredisë.

2 Klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA)

Vlerësimet e kredive nga institucionet e jashtme të vlerësimit të kredisë përdoren për:

- a) Ekspozimet ndaj qeverive qendrore
- b) Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura
- c) Ekspozimet ndaj shoqërive tregtare

kurdo që një vlerësim i tillë ekziston apo nuk mbivendoset nga rregulla të tjera të paracaktuara të rregullores "Per Raportin e Mjaftueshmerise se Kapitalit".

(II) Informacion sasior

1 Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë, para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

Nr.	Zerat e ekspozimeve dhe të ekspozimeve të mundshme	Tremujori I' 2015		Tremujori II' 2015		Tremujori III' 2015	
		Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë*) (ne Leke)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë**) (ne Leke)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë*) (ne Leke)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë**) (ne Leke)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë*) (ne Leke)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut kredisë**) (ne Leke)
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	37,788,080,650	36,539,054,650	36,618,460,030	35,369,879,030	33,050,094,680	33,050,094,680
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	158,423,150	158,423,150	158,372,081	158,372,081	103,855,028	103,855,028
3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/ofitimprurëse)	278,224,560	278,224,560	278,194,969	278,194,969	278,199,771	278,199,771
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	16,455,267,540	16,455,267,540	14,155,532,651	14,155,532,651	13,783,468,643	13,783,468,643
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	12,268,114,350	12,268,114,350	12,295,475,375	12,295,475,375	10,712,690,616	10,712,690,616
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	7,458,777,410	7,073,394,750	6,842,019,633	6,484,496,992	6,904,535,081	6,603,107,293
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruarat me kolateral pasuri të paluajtshme	4,563,752,180	4,563,752,180	3,621,464,098	3,621,464,098	3,077,116,350	3,077,116,350
8	Ekspozime (kredi) me probleme (pas zbritjes së fondeve rezerve)	5,249,899,320	5,249,899,320	4,902,918,729	4,898,263,813	5,215,802,353	5,212,067,589
9	Zëra të tjerë***	4,960,062,050	4,960,062,050	5,567,544,683.17***	5,567,544,683.17***	5,087,778,122	5,087,778,122
	Total	89,180,601,210	87,546,192,550	84,439,982,250	82,829,223,693	78,213,540,644	77,908,378,092

* Duke përfshirë vlerat e zerave jashtë bilancit para aplikimit të faktoreve të konvertimit.

** Banka e Tiranës përfor për qellime të zbutjes së rrezikut të kredive kolateralin financiar.

*** Vlera e ekspozimit e publikuar në T2 2015 është korrigjuar për Ekspozimet e klasifikuara në kategorinë "Zera të Tjere" nga 3,695,575,866 leke në 5,567,544,683. Ky korrigjim nuk ka ndikim në totalin e asetëve të ponderuara me rrezikun dhe rrjedhimisht edhe në normën e mjaftueshmerise se kapitalit.

2 Ekspozimet e zbritshme nga kapitali rregullator

Nr.	Ekspozimet e zbritshme nga kapitali rregullator	Tremujori I' 2015	Tremujori II' 2015	Tremujori III' 2015
		Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke
	Ekspozime të zbritshme nga kapitali rregullator	0	0	0
	Total	-	-	-

Tabela 8: Teknikat e zbutjes se rrezikut (cdo tremujor)

(I) Informacion cilesor

Informacion përmbledhës mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë:

Banka e Tiranës përdor si teknike të zbutjes së rrezikut të kredisë "Mbrojtjen e Financuar të Kredisë" e bazuar në përdorimin e Kolateralit Financiar, dhe përdor për këtë qëllim Metoden Gjithëpërfshirëse të Kolateralit Financiar.

Kolateralët e tjera si kolateralët rezidenciale dhe ato komerciale përdoren gjithashtu gjëra në procesin e kredidhenies, duke reduktuar rrezikun që rrjedh nga ekspozimet e kredisë. Për qëllime të përdorimit të tyre si teknika të zbutjes së rrezikut (në drejtim të aplikimit të faktoreve të reduktuar të rrezikut), kolateralët e natyrës rezidenciale, vlerësohen të pakten një herë në tre vjet nepermjet metodave statistikore të ngritura nga Banka dhe të pranueshme nga kuadri rregullator në fuqi. Kolateralët e natyrës komerciale vlerësohen çdo vit, gjatë procesit të rishikimit të dosjes së kredisë.

(II) Informacion Sasior

1 Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme), në rastin e përdorimit të mbrojtjes së financuar të kredisë

	Tremujori I' 2015	Tremujori II' 2015	Tremujori III' 2015
	Vlerat në Leke	Vlerat në Leke	Vlerat në Leke
Ekspozimi origjinal - zërat brenda dhe jashtë bilancit - përpara aplikimit të kolateralit financiar	89,180,601,210	84,439,982,250	78,213,540,644
Kolaterali Financiar	1,634,408,660	1,610,758,557	305,162,552
Ekspozimi (neto) - zërat brenda dhe jashtë bilancit - pas aplikimit të kolateralit financiar	87,546,192,550	82,829,223,693	77,908,378,092

2 Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme), në rastin e përdorimit të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë

Mbrojtja e pafinancuar e kredisë nuk është e aplikueshme në portofolin e Bankës së Tiranës.

Tabela 9: Rreziku i kredisë së kundërpatisë (çdo tremujor)

(I)

Informacion cilesor

Informacion përmbledhës mbi derivativët dhe rrezikun e kredisë së kundërpatisë :

Gjate tremujorit te trete te vitit 2015 ashtu sikurse edhe gjate tremujorit te dyte dhe te pare te vitit 2015, Banka e Tiranës nuk ka perlogaritur kerkese per kapital per rrezikun e kredise se kunderpartise si pasoje e mungeses se ekspozimeve ne librin e bankes dhe librin e tregtueshem te tilla si:

- 1.Instrumentet derivative mbi banak;
- 2.Derivativet e kredise;
- 3.Marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes së letrave me vlerë (me perjashtim te transaksioneve te tilla me Banken e Shqiperise te cilat nuk kerkojne kapital) dhe të mallrave, transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së letrave me vlerë dhe të mallrave;
- 4.Transaksionet e huadhënies me marzhe të letrave me vlerë;
- 5.Transaksionet me afat të gjatë shlyerje.

Tabela 10 : Titullzimi (cdo tremujor)

(I) Informacion cilesor

Banka e Tiranes nuk ka ekspozime te titullzuara.

Tabela 11 : Rreziqet e Tregut: Informacion i pergjithshem (cdo 6-mujor)

(I) Informacion cilesor

1

Informacion permbledhes cilesor, per rreziqet e tregut sipas kerkesave te rregullores "Per raportin e mjaftueshmerise se kapitalit"

Banka e Tiranes llogarit kerkesen per kapital per rrezikun e tregut si shume te:

a) kerkeses per kapital per aktivitetin ne librin e tregtueshem dhe

b) kerkesen per kapital per te gjitha pozicionet e bankes (pozicione ne librin e tregtueshem dhe pozicione ne librin e bankes).

Banka e Tiranes nuk ka ne portofolin e saj te letrave me vlere tituj te tregtueshem, rrjedhimisht nuk llogarit kerkesa per kapital per aktivitetin ne librin e tregtueshem. Gjithashtu, ajo nuk ka ne fund te tremujorit te trete te vitit 2015 pozicione ne mallra dhe transaksione me rrezik te shlyerjes duke mos llogaritur kerkesa per kapital per kete portofol.

Banka e Tiranes kryen monitorim te vazhdueshem te rrezikut ndaj normes se interesit dhe kursit te kembimit, duke ruajtur nivelet e ketyre te fundit brenda limiteve te kuadrit rregullativ dhe limiteve te saj te brendshme.

Ne tremujorin e trete te vitit treguesi rregullativ i rrezikut te normes se interesit perlllogaritet ne nivelin 1.48% perkundrejt nivelit 0.58% perlllogaritur gjate tremujorit te dyte te vitit dhe nivelit 2.87% perlllogaritur gjate tremujorit te pare te vitit 2015

Nderkohe, pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator gjate tremujorit te trete te vitit llogaritet ne nivelin 2.7% perkundrejt nivelit 1.04% perlllogaritur ne tremujorin e dyte te vitit dhe nivelit 1.88% perlllogaritur ne tremujorin e pare te vitit 2015

(II) Informacion sasior

Ne fund te tremujorit te trete te vitit 2015 pozicioni i hapur valutor neto shenon vlere mbi 2% te kapitalit rregullator te bankes (konkretisht vlere 2.7%), duke rrjedhuar keshtu ne perlllogaritje te kerkeses per kapital per rrezikun e tregut, sikunder parashikohet nga kuadri rregullativ ne fuqi. Sa me poshte prezantuar si kerkesa per kapital per rrezikun e tregut reflekton kerkesen per kapital per rrezikun e kursit te kembimit.

	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke	Vlerat ne Leke
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut	-	-	18,615,473
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut e shumezuar me 12.5	-	-	232,693,413

Tabela 12: Rreziku operacional (cdo tremujor)

(I) Informacion sasior

1 Informacion përmbledhës për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (metoda standarde)

Banka e Tiranës përdor metodën standarde për të përlogaritur kërkesën për kapital për rrezikun operacional. Sipas kësaj metode, aktiviteti i bankës ndahet në 8 linja biznesi dhe banka përlogarit të ardhurat bruto për çdo linjë biznesi për tre vitet e fundit.

a) Kërkesa për kapital për çdo linjë biznesi përlogaritet duke shumëzuar të ardhurat bruto në një vit të dhënë me një koeficient Beta që varion nga 12%-18% (sipas përcaktimeve të rregullores).

b) Nëse rezultati i llogaritur (në pikën a) për një vit është negativ, atëherë vlera për vitin përkatës konsiderohet 0 (zero).

c) Kërkesa për kapital e bankës është mesatarja e tre viteve të fundit e shumëzuar me rezultatin të llogaritur në pikën a.

Për tremujorin e tretë të vitit 2015, kërkesa për kapital për Rrezikun Operacional vlerësohet të jetë rreth 439.4 milion leke (e njëjta me vlerën e përlogaritur gjatë tremujorit të dytë të vitit) kundrejt vlerës 463.7 milion leke të llogaritur gjatë tremujorit të parë të vitit*.

* Ndryshimi në vlerë të kërkesës për kapital për Rrezikun Operacional gjatë tremujorit të II krahasuar me tremujorin e I ka ardhur si rezultat i një korrigjimi në përlogaritjen e kësaj kërkesë.

(II) Informacion sasior

1 Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas metodës standarde, të përcaktuar në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuar me 12.5

	Tremujori I' 2015	Tremujori II'2015	Tremujori III'2015
	Vlerat në Leke	Vlerat në Leke	Vlerat në Leke
Kërkesa për kapital për rrezikun operacional	463,707,086	439,474,264	439,474,264
Kërkesa për kapital për rrezikun operacional e shumëzuar me 12.5	5,796,338,571	5,493,428,297	5,493,428,297

Tabela 13 : Ekspozimet ne instrumentat e kapitalit: Informacion mbi pozicionet e perfshira ne librin e bankes (cdo tremujor)

(I)

Informacion cilesor

Informacion permbledhes lidhur me investimet ne aksione te perfshira ne librin e bankes

Banka e Tiranes zoteron 19,584 aksione te zakonshme, klasa C, te kompanise VISA Corporation me vlere nominale 15,768,823 leke. Aksionet ne Visa Inc te poseduara nga Banka jane dhuruar nga Visa si nje forme shperblimi per bashkepunimin afatgjate me banken. Aksionet jane dhuruar ne baze te performances mbi te ardhurat dhe objektivat e shpenzimeve te marketingut.)

Tabela 14 : Rreziku i normes se interesit ne librin e bankes (cdo tremujor)

(I) Informacion cilesor

Informacion permbledhes mbi ekspozimet ndaj rrezikut te normes se interesit ne pozicionet ne librin e bankes:

Banka e Tiranes kryen monitorim te vazhdueshem te rrezikut ndaj normes se interesit, duke ruajtur nivelet e treguesve te matur per kete qellim brenda limiteve te kuadrit rregullativ dhe limiteve te saj te brendshme.

Ne tremujorin e trete te vitit, treguesi rregullativ i rrezikut te normes se interesit perlogaritet ne nivelin 1.48%.

(II) Informacion sasior

Treguesi i rrezikut te normes se interesit ne librin e bankes ndaj kapitalit rregullator	Periudha	Shtator 2014	Dhjetor 2014	Mars 2015	Qershor 2015	Shtator 2015
	Niveli	3.33%	4.65%	2.87%	0.58%	1.48%
	Limit rregullativ	20%	20%	20%	20%	20%

Banka e Tiranes perlogaritet gjithashtu tregues te brendshem mbi rrezikun e normes se interesit, konkretisht EAR dhe PV100. Niveli i EAR per tremujorin e trete te vitit 2015 perlogaritet ne nivelin 1.45 milion euro perkundrejt vleres 1.51 milion euro llogaritur ne tremujorin e dyte dhe 1.56 milione euro llogaritur ne tremujorin e pare te vitit. Niveli i treguesit PV100 per tremujorin e trete te vitit llogaritet 0.23 milion euro kundrejt 0.73 milion euro llogaritur ne tremujorin e dyte dhe 0.67 milione euro llogaritur ne tremujorin e pare te vitit 2015. Limitet per secilin tregues jane perkatesisht 2.5 milione euro dhe 1.5 milione euro.

Tabela 15: Rreziku i likuiditetit (cdo tremujor)

(I) Informacion Cilesor

Totali i depozitave te Bankes se Tiranës vlerësohet ne fund te tremujorit te trete te vitit 2015 ne nivelin 461 milione euro kundrejt 489 milione euro llogaritur ne tremujorin e dyte dhe kundrejt 527 milione euro llogaritur ne tremujorin e pare te vitit 2015. Depozitat me afat perbejne 76.4% te totalit te depozitave kundrejt 77.7% te totalit te depozitave llogaritur ne tremujorin e dyte dhe 77% te totalit te depozitave te llogaritura ne tremujorin e pare. Perberja e depozitave me afat sipas monedhave tregon per 58% te depozitave ne monedhen vendase (leke) ne tremujorin e trete kundrejt 56.8% ne tremujorin e dyte dhe 55.7% ne leke llogaritur ne tremujorin e pare te vitit; 38% ne euro ne tremujorin e trete kundrejt 39.2% ne euro ne tremujorin e dyte dhe 39.5 % ne euro llogaritur perkatesisht ne tremujorin e pare te vitit dhe 3.3% ne usd ne tremujorin e trete kundrejt 3.5% ne usd ne tremujorin e dyte dhe 4.3% ne usd llogaritur ne tremujorin e pare te vitit. Perberja sipas monedhave e depozitave me afat dikton edhe perberjen sipas monedhave te totalit te depozitave. Pergjate tremujorit te trete te vitit totali i depozitave ka rëne me rreth 6.3% kundrejt tremujorit te dyte te vitit.

Banka e Tiranës kryen monitorime ditore te rrezikut te likuiditetit nepermjet strukturave te saj ne Departamentin e Thesarit, Finances dhe Administrimit te Rrezikut.

(II) Informacion Sasior

Treguesit baze te rrezikut te likuiditetit - Mars 2015	Mars 2015	Qershor 2015	Shtator 2015	Limiti rregullativ
Kredi / Depozita	58%	60.8%	64.2%	NA
Kredi neto / Depozita	38.8%	39.4%	41.4%	NA
Treguesi rregullativ i likuiditetit (aktive likuide / pasive afatshkurtra) -	55%	55.6%	58.3%	30%
Treguesi rregullativ i likuiditetit (aktive likuide / pasive afatshkurtra) -	40.3%	37.1%	38.9%	25%
Treguesi rregullativ i likuiditetit (aktive likuide / pasive afatshkurtra) -	71%	77.6%	80.1%	25%
Tregues te perqendrimit te depozitave:				
<i>a) 10 depozituesit me te medhenj</i>	3.1%	2.8%	2.3%	NA
<i>b) 20 depozituesit me te medhenj</i>	4.7%	4.1%	3.7%	NA
<i>c) 50 depozituesit me te medhenj</i>	7.5%	6.3%	6.1%	NA
Shoku i rrezikut te likuiditetit - supozim: 30% terheqje e depozitave - efekti mbi aktivet likuide	55.5%	52.9%	54.7%	NA

Treguesit baze te likuiditetit tregojne per nje situatë te qendrueshme te Bankes se Tiranës. Te gjithë treguesit rregullative qendrojnë ne fund te tremujorit te trete te vitit brenda limiteve rregullative. Perqendrimi i depozitave vlerësohet te jete i ulet si pasoje e bazes tejet te diversifikuar te depozituesve. Monitorimi i shokut te rrezikut te likuiditetit si dhe gap-eve te likuiditetit (vlerësuar sipas flukseve te pritshme), tregojne per nivele te ketyre treguesve brenda politikës se bankes.